



USAID | **ALBANIA**
FROM THE AMERICAN PEOPLE

PËRMBLEDHJE E QEVERISJES VENDORE NË SHQIPËRI PËR QËLLIME HUAMARRJEJE

TË DHËNA FINANCIARE PËR 10 BASHKITË E
SYNUARA NËN PROGRAMIN E USAID-IT PËR
QEVERISJEN VENDORE NË SHQIPËRI

MAJ 2008

Ky botim u përgatit për shqyrtim nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar. Ai u përgatit nga ARD, Inc.

Përgatitur për Agjensinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar, Numri i Kontratës me USAID-in DFD-I-00-05-00121-00, Urdhëri i Punës 05, nën IQC e Decentralizimit dhe Qeverisjes Demokratike Vendore (Decentralizimi II)

Kontakti Kryesor i ARD-së: Ruzan Aghazadyan

Përgatitur nga: Ornela Shapo (Këmbora),
Zhvillimi i Ekonomisë Vendore / Drejtues komponenti,
USAID/LGPA

Adresa e Zyrës Qendrore të ARD-së: ARD, Inc.
159 Bank Street, Suite 300, Burlington, VT 05401
Tel: 802 658-3890, Fax 802 658-4247
www.ardinc.com

PËRMBLEDHJE E QEVERISJES VENDORE NË SHQIPËRI PËR QËLLIME HUAMARRJEJE TË DHËNA FINANCIARE PËR 10 BASHKITË E SYNUARA NËN PROGRAMIN E USAID-IT PËR QEVERISJEN VENDORE NË SHQIPËRI

MAJ 2008

SQARIM

Ky dokument u përgatit nga Ornela Shapo eksperte e LGPA-së. Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjensisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	i
SHKURTIME	ii
1.0 Përmbledhje e Pushtetit Vendor	1
1.1 KUFIJTË ADMINISTRATIVË DHE ORGANIZIMI I NJËSIVE TË PUSHTETIT VENDOR.....	1
Tabela 1. Ndarja administrative e 10 bashkive të synuara të LGPA-së.....	2
1.2 FUNKSIONET DHE TË DREJTAT E NJËSIVE TË PUSHTETIT VENDOR.....	3
1.3 FONDET FINANCIARE TË PUSHTETIT VENDOR.....	4
1.3.1 Struktura e Buxhetit Vendor.....	4
1.3.2 Taksat Kryesore Vendore.....	6
1.3.3 Tarifat Kryesore Vendore.....	6
Tabela 2. Baza e taksave dhe tarifave dhe niveli i tyre.....	7
Tabela 3. Llogaritjet për detyrimin e taksave të biznesit të vogël.....	9
1.3.4 Taksat e përbashkëta 10	
Tabela 4. Buxheti i shtetit dhe të ardhurat e pushtetit vendor (në milionë lekë).....	11
1.4 SHPENZIMET E PUSHTETIT VENDOR.....	11
Tabela 3. Buxheti i shtetit dhe të ardhurat e pushtetit vendor (të dhënat makro—në milionë lekë)..	12
2.0 HUAMARRJA E PUSHTETIT VENDOR	13
2.1 LIGJI PËR HUAMARRJEN E QEVERISJES VENDORE	13
2.1.1 Titujt e Pushtetit Vendor 13	
2.1.2 Kufizimet e Borxhit 14	
2.2 KUFIRI PARAPRAK I HUAMARRJES PËR BASHKITË E SYNUARA.....	14
Tabela 4. Kufizimi i huamarrjes për bashkitë e synuara të programit LGPA (në milionë lekë)	14
Tabela 5. Kufizimi i huamarrjes për bashkitë e synuara të programit LGPA (në milionë euro).....	15
SHTOJCA A. TË DHËNA EKONOMIKE PËR BASHKITË E SYNUARA TË LGPA	16
Tabela 6. Të ardhurat e bashkive të synuara të programit LGPA (2007).....	16
Tabela 7. të dhëna buxhetore për 10 bashkitë e programit LGPA, 2003-2007 (faktik) dhe 2008 (plani)	16

SHKURTIME

ABV	Të ardhura nga burimet e veta
KEQV	Karta Evropiane e Qeverisjes Vendore
LGPA	Programi i Qeverisjes Vendore në Shqipëri
MF	Ministria e Financave
PKB	Prodhimi Kombëtar Bruto
PV	Pushteti Vendor
QQ	Qeveria Qëndrore
SKDAV	Strategjia Kombëtare për Decentralizimin dhe Autonominë Vendore
TVSH	Tatim mbi Vlerën e Shtuar
USAID	Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar

1.0 PËRMBLEDHJE E PUSHTETIT VENDOR

Fillimi i periudhës së tranzicionit në Shqipëri, 1991-1992, nisi me decentralizimin politik si fokusi kryesor i ngritjes së pushtetit vendor (PV) si pushtet i zgjedhur me votë të drejtpërdrejtë. Megjithatë, pas këtyre nismave të para të decentralizimit, qeveria qendrore (QQ) e përqëndroi vëmendjen e saj krejtësisht në reformat kombëtare, të tilla si stabiliteti makroekonomik, ekonomia e tregut, privatizimi, ristrukturimi i sistemit bankar, etj., dhe jo në zhvillimin e pushteteve nga pushteti qendror në pushtetin vendor. Si rezultat, edhe pse qeverisja qendrore në Shqipëri ushtrohej brenda kuadrit politik të decentralizimit, njësitë e pushtetit vendor nuk kishin autoritet apo përgjegjësi të vërtetë në ushtrimin e funksioneve të tyre apo autoritetin fiskal për të krijuar të ardhura vendore. Sistemi nuk krijonte stimuj që pushteti vendor të vepronte në emër të qytetarëve të tij; përkundrazi, njësitë e pushtetit vendor shpesh vepronin si zgjerim apo agjensi i pushtetit qendror.

Statusi i pushtetit vendor filloi të ndryshonte në muajin maj të viti 1998 me nënshkrimin e Kartës Evropiane të Pushtetit Vendor si dhe me hartimin dhe miratimin e Kushtetutës së re të Shqipërisë. Sipas Kushtetutës, Shqipëria është shtet unitar me dy nivele të pushtetit vendor: bashkia/komuna në nivelin e parë dhe qarku në një nivel më të lartë. Pushteti vendor në Shqipëri bazohet në parimin e decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore.

Që nga viti 1998, u hodhën disa hapa të rëndësishëm për të krijuar njësitë autonome të pushtetit vendor me autoritetin e plotë për të administruar një pjesë të rëndësishme të sektorit publik. Modeli shqiptar i decentralizimit u formua edhe më tej në Strategjinë Kombëtare për Decentralizimin dhe Autonominë Vendore, e cila u miratua nga Qeveria qendrore në vitin 2000.

Deri tani, zbatimi i strategjisë kombëtare, dhe reforma e decentralizimit në përgjithësi, ka patur një mirëkuptim të gjerë dhe të plotë. Në një farë mase, reforma e decentralizimit nuk është kontestuar kurrë apo mohuar nga asnjë forcë politike në vend. Kjo nënkupton se ka një vullnet të fortë politik dhe serioz për të vazhduar përpara me vënien në zbatim të strategjisë.

1.1 KUFIJTË ADMINISTRATIVË DHE ORGANIZIMI I NJËSIVE TË PUSHTETIT VENDOR

Komunat dhe **bashkitë** përbëjnë nivelin bazë të pushtetit vendor në Shqipëri dhe qarqet përbëjnë nivelin e dytë.

Organi përfaqësues i komunës është Këshilli i Komunës, i drejtuar nga Kryetari i Komunës. Bashkitë përfaqësohen nga Këshillat Bashkiakë, të cilat drejtohen nga Kryetari i Bashkisë. Kryetarët e këshillave bashkiakë dhe kryetari i bashkisë zgjidhen me votë të drejtpërdrejtë në formën që përcaktohet në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë për një mandat katër vjeçar. Zgjedhjet e fundit vendore u mbajtën në shkurt të vitit 2007. Anëtarët e këshillit të bashkisë/komunës zgjidhen me anë të listës së partive politike në të njëjtën zgjedhje për një mandat katër vjeçar.

Qarku është një organ territorial-administrative që përbëhet nga disa komuna dhe bashki, të cilat kanë lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike dhe shoqërore si dhe interesa të përbashkëta. Kufijtë e secilit

qark përbëhen nga kufijtë e komunave dhe bashkive nën juridiksionin e tij. Qendra e qarkut ndodhet në një nga bashkitë nën juridiksionin e tij. Territori, emri dhe qendra e secilit qark përcaktohen në Ligjin Nr. 8652, datë 31 korrik 2000, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore.”¹

Niveli i dytë i pushtetit vendor, këshillat e qarqeve, është aktualisht duke u shqyrtuar dhe mund të ndryshohet. Diskutimet po përqëndrohen në dy modele të mundshme: i) ruajtja e modelit aktual siç përcaktohet edhe në Kushtetutë, ose ii) ndryshimi për të kaluar në këshilla të zgjedhur drejtpërdrejtë. Ende nuk është marrë një vendim përfundimtar.

Shqipëria ka **65 bashki** dhe **308 komuna**, që përbëjnë edhe **12 qarqe**.

Programi i Qeverisjes Vendore në Shqipëri, i mbështetur nga USAID, po punon aktualisht me 10 bashki në të gjithë vendin. Përbërja e tyre administrative jepet në tabelën 1.

TABELA 1. Ndarja administrative e 10 bashkive të synuara të LGPA-së

Nr.	Rajoni	Rrethi	Bashkia	Qytete dhe fshatra të përfshirë
1	Durrës	Krujë	Fushë-Krujë	1 qytet: • Fushë-Krujë 6 fshatra: • Fushë-Krujë Arrameras • Luz • Hasan • Larushk • Halil
2	Elbasan	Gramsh	Gramsh	1 qytet: • Gramsh 9 fshatra: • Pishaj • Trashovicë • Shëmrizë • Ostrenth • Gurrëz • Cerunjë • Çekin • Qerret • Koçaj
3	Lezhë	Lezhë	Lezhë	1 qytet • Lezhë
4	Korçë	Korçë	Korçë	1 qytet: • Korçë
5	Korçë	Pogradec	Pogradec	1 qytet: • Pogradec
6	Elbasan	Librazhd	Librazhd	1 qytet: • Librazhd
7	Shkodër	Shkodër	Shkoder	1 qytet: • Shkoder 2 fshatra:

¹ Shpesh përdoret edhe termi “rreth” për referencë vendore, por termi “rreth” ka dalë pothuajse jashtë përdorimit (nuk është më pjesë e ndonjë ligji specifik që klasifikon strukturat dhe organizimin e pushtetit vendor). Më parë, vendi përbëhej nga 36 rrethe. Megjithatë, shumë zyra të pushtetit qendror në qarqe, p.sh., gjykatat, zyrat e thesarit të Ministrisë së Financave, dhe degët e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Taksave, ndodhen ende në të ashtuquajturat rrethe, ndaj ky term gjen ende përdorim.

Nr.	Rajoni	Rrethi	Bashkia	Qytete dhe fshatra të përfshirë
				<ul style="list-style-type: none"> • Shiroke • Zogaj
8	Fier	Fier	Fier	1 qytet: <ul style="list-style-type: none"> • Fier
9	Vlorë	Vlorë	Himarë	1 qytet: <ul style="list-style-type: none"> • Himarë 9 fshatra: <ul style="list-style-type: none"> • Pilur • Kudhës • Qeparo Fshat • Qeparo Fushë • Vuno • Iliaz • Dhërmi • Gjilekë • Palasë
10	Kukës	Kukës	Kukës	1 qytet: <ul style="list-style-type: none"> • Kukës 3 fshatra: <ul style="list-style-type: none"> • Gostil • Koder Lume • Drinas

1.2 FUNKSIONET DHE TË DREJTAT E NJËSIVE TË PUSHTETIT VENDOR

Ligji “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore” përcakton *tre lloje funksionesh për njësitë e pushtetit vendor: i) funksione të veta, ii) funksione të përbashkëta, dhe iii) funksione të deleguara* (si të detyrueshme ashtu edhe jo të detyrueshme). Po ashtu, ai përcaktohen edhe disa lloje kompetencash, të tilla si rregullatore, administrative, investime dhe shërbime.

- **Funksionet e veta** i jepen njësive të pushtetit vendor nga ligji për realizimin e të cilave pushteti vendor është përgjegjës dhe ka autoritetin për të marrë vendime dhe të përdorë mjete për realizimin e tyre, brenda normave, kritereve dhe standardeve të pranuar në ligj në përgjithësi. Pushteti vendor ka kompetenca të plota administrative, shërbimi, investimi dhe rregullatore në lidhje me këto funksione.

Funksionet kryesore të ushtruara aktualisht nga njësitë e pushtetit vendor përfshijnë shërbimet publike bazë (ndriçimi i rrugëve, gjelbërimi, pastrimi i rrugëve, etj.) mirëmbajtja e rrugëve, mirëmbajtja e shkollave dhe mjediseve të kujdesit shëndetësor parësor si dhe kopshtet. Në funksionet e veta të përcaktuara në ligjin organik, furnizimi me ujë, kanalizimet dhe planifikimi urban ende nuk janë decentralizuar plotësisht. Sipas rendit politik të qeverisë qendrore, decentralizimi i këtyre sektorëve pritet të përfundojë në fund të vitit 2008. Disa nga ndërmarrjet e ujësjellësit janë transferuar pothuajse plotësisht tek njësitë përkatëse të pushtetit vendor.

- **Funksione të përbashkëta** janë ato për të cilat njësitë e pushtetit vendor ndajnë përgjegjësinë, veçmas nga ndarja e përgjegjësisë që i përket qeverisë qendrore, dhe funksionet shoqërohen proporcionalisht me kompetenca, të cilat ushtrohen në mënyrë të pavarur.

Përsa i përket funksioneve të përbashkëta që përcaktohen në ligj (arsimi 9-vjeçar dhe i mesëm, kujdesi shëndetësor parësor dhe asistencë sociale), reforma e decentralizimit ose është në fazat e para ose është ende e paqartë.

- **Funksiione të deleguara** janë ato që i delegohen me ligj ose me një marrëveshje kontraktuale të pushtetit qëndror apo institucione në varësi të tij me njësitë e pushtetit vendor për realizimin në shkallën dhe mënyrën që përcaktohet nga qeveria qëndrore apo institucionet në varësi të saj.

Komunat dhe bashkitë i ushtrojnë funksionet e tyre në përputhje me politikat vendore dhe kombëtare. Qeveria qëndrore mund të nxjerrë standarte kombëtare në lidhje me funksionet ekskluzive të pushtetit vendor për qëllimin e vetëm të përmbushjes së një interesit specifik kombëtar, me kusht që ky standart kombëtar nuk kufizon të drejtën e pushtetit vendor në fushat që kanë të bëjnë qartësisht me interesat vendore. Në ato raste ky pushteti vendor nuk ka burime të mjaftueshme për të përmbushur një standart kombëtar, qeveria qëndrore duhet t'i ofrojë pushtetit vendor mbështetjen e nevojshme që ky i fundit të përmbushë standartin kombëtar.

Sipas Ligjit “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, njësitë e pushtetit vendor gëzojnë këto të drejta:

- E drejta e qeverisjes,
- E drejta e pronësisë,
- Autonomi fiskale (E drejta e mbledhjes së të ardhurave dhe e bërjes së shpenzimeve)
- Zhvillimi ekonomik (E drejta e kryerjes së veprimtarive ekonomike),
- E drejta e personit juridik, dhe
- Të drejta të tjera që përcaktohen në ligj.

1.3 FONDET FINANCIARE TË PUSHTETIT VENDOR

Njësitë e pushtetit vendor financohen me të ardhurat nga:

- Taksat dhe tarifatat vendore,
- Fondet të transferuara nga pushteti qendror (të pakushtëzuara dhe të kushtëzuara), si dhe
- Fonde që rrjedhin nga taksa të përbashkëta kombëtare.

Sipas ligjit, komunave dhe bashkive u jepet autoriteti për të vjelur në mënyrë të pavarur të ardhura që përdoren për të financuar funksionet e tyre ekskluzive nën juridiksionin e tyre.

Pushteti qendror jep fonde për njësitë e pushtetit vendor për përmbushjen e kërkesave për realizimin e funksioneve të deleguara dhe të përbashkëta.

Secila njësi e pushtetit vendor miraton, zbaton dhe administron një buxhet vjetor që **nuk duhet të përfshijë një deficit**.

Struktura ekzistuese e buxhetit të pushtetit vendor përfshin të gjitha burimet e financimit dhe shpenzimet. Struktura e të ardhurave jepet më poshtë.

1.3.1 Struktura e Buxhetit Vendor

1. Të ardhurat (financimi vendor):

1.1 Të ardhurat e vetë pushtetit vendor (për të mbuluar shpenzimet operative dhe të kapitalit)

1.1.1 Taksat dhe tarifatat vendore²

² Dy nga taksat vendore, taksa për regjistrimin e automjeteve dhe taksa për transferimin e pronave të patundshme ligjërisht përcaktohen si taksa vendore në Ligjin për Sistemin e Taksave të Qeverisjes Vendore. Megjithatë, njësitë e pushtetit vendor nuk kanë kompetenca mbi shumë e taksës, mbi vendosjen ose jo të këtyre taksave dhe ato nuk i vjelin këto taksa. Përkundarzi,

- 1.1.1.1 Taksa vendore
- 1.1.1.2 Tatime vendore
- 1.1.2 Të ardhura jo nga taksat
 - 1.1.2.1 Qera
 - 1.1.2.2 Privatizimi i pronave të njësisë të pushtetit vendor
- 1.1.3 Taksa të përbashkëta
- 1.2 **Grantet/Transfertat e pakushtëzuara** (transfertat nga pushteti qëndror në pushtetin vendor);
 - 1.2.1 Transferta të pakushtëzuara për mbulimin e shpenzimeve operative
 - 1.2.2 Transferta të pakushtëzuara për investime
 - 1.2.3 Grante konkurruese³ - Transferta të pakushtëzuara për investime konkurruese
- 1.3 **Transferta të kushtëzuara** (nga pushteti qëndror tek pushteti vendor nëpërmjet ministrive të linjës)
 - 1.3.1 Shpenzime operative për pagat dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore në arsim dhe shëndetësi
 - 1.3.2 Shpenzimet të tjera operative për mirëmbajtjen dhe ristrukturimin në arsim, shëndetësi, infrastrukturë, turizëm, etj.
 - 1.3.3 Shpenzime kapitali në arsim, shëndetësi, infrastrukturë, ujësjellës, etj.
 - 1.3.4 Shpenzime për asistencën sociale

Komunat dhe bashkitë kanë të drejtën të krijojnë të ardhura nga:

- Taksat dhe tarifatat vendore mbi pronat e tundshme dhe të patundshme, si dhe nga transaksionet e kryera me to;
- Taksat dhe tatimet vendore mbi veprimtarinë ekonomike të bizneseve të vogla, të shërbimit hotelier, restoranteve, bareve si dhe shërbime të tjera;
- Taksat dhe tarifatat vendore mbi të ardhurat personale që vijnë nga donacionet, trashëgimitë, testamentet, dhe nga lotaritë vendore; dhe
- Taksa dhe tarifa të tjera të përcaktuara në ligj

Ligji për Sistemin e Taksave të Qeverisjes Vendore përcakton taksën bazë si dhe koeficientin minimal dhe maksimal. Për taksat vendore, njësitë e pushtetit vendor mund të modifikojnë bazën e taksës deri në +/-30% të taksës me anë të një vendimi të këshillit të njësisë vendore. Komunat dhe bashkitë kanë të drejtën të vendosin aplikimin ose jo të taksave vendore. Në rast se vendosin të aplikojnë taksën, ato përcaktojnë shumën e taksës si dhe mënyrën për vjeljen dhe administrimin brenda kufijve dhe kriterëve të përcaktuara në ligjin përkatës.

Njësitë e pushtetit vendor nxjerrin të ardhura edhe nga tarifatat vendore për:

taksa (shuma e saj) përcaktohet nga Parlamenti dhe taksa vilet nga pushteti qëndror dhe më pas transferohet tek njësitë e pushtetit vendor (duke zbritur një tarifë për vjeljen e kësaj takse).

³ Grantet konkurruese akordohen çdo vit. Është ngritur një bord vlerësimi në të cilin bëjnë pjesë përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, ministrinë e linjës (Ministria e Arsimit, Ministria e Transporteve, Ministria e Shëndetësisë, etj.) dhe nga Shoqata e Bashkive dhe Shoqata e Komunave.

- Shërbime publike të ofruara nga njësitë e pushtetit vendor;
- E drejta për të përdorur pronat publike të njësisë vendore, dhe
- Dhënia e licensave, lejeve, autorizimeve dhe dhënia e dokumenteve të tjera, për të cilat njësitë e pushtetit vendor kanë autoritet të plotë.

Njësitë e pushtetit vendor përcaktojnë nivelin e tarifave vendore si dhe vendosin për mënyrën e mbledhjes së tarifave vendore dhe administrimin e tyre. Njësitë e pushtetit vendor mund të marrin hua për qëllime publike brenda limitit të përcaktuar në Ligjin “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”

Përveç të ardhurave me natyrë fiskale, njësitë e pushtetit vendor mund të krijojnë të ardhura edhe nga veprimtaritë ekonomike, qeratë, shitjet e pronave si dhe nga donacione, të ardhura nga interesat dhe nga gjobat.

1.3.2 Taksat Kryesore Vendore

- Taksa mbi pronën;
- Taksa e biznesit të vogël;
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë;
- Taksa e shërbimit hotelier;
- Taksa e xhiros së restorantit, hoteleve, etj.;
- Taksa e tokës bujqësore;
- Taksa të përkohshme; dhe
- Të tjera.

1.3.3 Tarifat Kryesore Vendore

- Tarifa e pastrimit,
- Tarifa e përdorimit të pronës/hapësirës publike,
- Tarifa e tabelave,
- Tarifa e ndriçimit të rrugëve,
- Tarifa e gjelbërimit,
- Tarifa e regjistrimit të biznesit,
- Tarifa për reklamimin e veprimtarisë së biznesit,
- Tarifa e parkimit,
- Tarifa për shërbimet e qeverisë vendore, dhe,
- Tarifa për shërbimet sociale/arsimore (arsimi parashkollor, konviktet e nxënësve/studentëve, etj.).

TABELA 2. BAZA E TAKSAVE DHE TARIFAVE DHE NIVELI I TYRE

Nr.	Emërtimi i taksës/tarifës	Njësia e taksës	Niveli i taksës
I	Taksat vendore		
1	Taksa e ndërtesave		
1.1	Ndërtesa rezidenciale		
1.1.1	Ndërtuar para 1993	Metër katror (m ²)	10 Lek
1.1.2	Ndërtuar pas 1993	Metër katror (m ²)	12 Lek
1.2	Ndërtesa jo-rezidenciale		
1.2.1	Shërbime/tregti	Metër katror (m ²)	150 Lek
1.2.2	Të tjera	Metër katror (m ²)	30 Lek
2	Taksa mbi token bujqësor	Shikoni tabelën 4 dhe 5	
3	Taksa e hotelit	Çmimi i dhomës	Deri në 5 % të çmimit të dhomës
4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë ⁴	Vlera e investimit të ri	1-3 %
5	Taksa për zënien e hapësirës publike		
6	Taksa e sinjalistikës		
7	Taksa e biznesit te vogël	Shikoni tabelën 3	
8	Taksa të përkohshme		
II	Të ardhura fiskale nga pushteti qendror (administruar nga qendra dhe transferuar në NJPV)		
1 ⁵	Taksa për regjistrimin e automjeteve		
1.1	Motoçikleta	Numri i motorit	600 Lek
1.2	Veturë me më pak ose të barabarta me 4+1 vende	Numri i veturës	2400 Lek
1.3	Veturë ose mini-furgon me më shumë se 4+1 dhe më pak se 8+1 vende	Numri i veturës	4800 Lek
1.4	Autobus me më pak ose barabartë me 32+1 vende	Numri i autobusit	6000 Lek
1.5	Autobus me më pak ose barabartë me 42+1 vende	Numri i autobusit	7200 Lek
1.6	Autobus me më shumë se 42 +1 vende	Numri i autobusit	8400 Lek
1.8	Kamion dhe furgon me peshë maksimale të autorizuar 3.5 ton	Numri i furgonit	3600 Lek
1.9	Furgon me peshë maksimale të autorizuar 3.5 ton deri në 7.5 ton	Numri i furgonit	4800 Lek
1.10	Furgon me peshë maksimale të autorizuar 7.5 ton deri në 18 ton	Numri i furgonit	6000 Lek
1.11	Furgon me peshë maksimale të autorizuar mbi 18 ton	Numri i furgonit	8000 Lek
1.12	Makineri ndërtimi dhe bujqësore me peshë maksimale të autorizuar deri në 7.5 ton	Numri i makinerisë	3000 Lek
1.13	Makineri ndërtimi dhe bujqësore me peshë maksimale të autorizuar prej më shumë se 7.5 ton	Numri i makinerisë	3600 Lek
1.14	Trailer me peshë maksimale të autorizuar prej 7 ton	Numri i trailerit	3000 Lek
1.15	Trailer me peshë maksimale të autorizuar prej më shumë se 7 ton	Numri i trailerit	4000 Lek
2	Taksa për transaksione me pasuritë e patundshme		
2.1	Ndërtesa rezidenciale (banesa)	Vlera e shitjes	2%
2.2	Ndërtesa për tregti dhe biznes	Vlera e shitjes	2%

⁴ Për Tiranën kjo taksë është 2-4%

⁵ Për të gjithë këtë kategori niveli i taksës jepet në lekë

2.3	Ndërtesa të tjera	Vlera e shitjes	2%
III	Tarifa vendore		
1	Tarifa e pastrimit		
2	Tarifa e përdorimit të pronës/hapësirës publike		
3	Tarifa e tabelave		
4	Tarifa e ndriçimit të rrugëve		
5	Tarifa e gjelbërimit		
6	Tarifa e regjistrimit të biznesit		
7	Tarifa e reklamës		
8	Tarifa e parkimit		
9	Tarifa të tjera për shërbime administrative		
10	Tarifa për shërbime sociale (si arsimi, konviktet e studentëve, etj.)		
11	Sporti dhe kultura		
12	Tarifa të tjera		

Këshilli i bashkisë ose komunës përcaktojnë nivelin dhe bazën e taksës të:

- a. Të gjitha tarifave vendore
- b. Taksës për zënien e hapësirës publike
- c. Taksave të përkohshme vendore

Për taksat e tjera, këshilli i bashkisë ose komunës përcakton nivelin e taksës që ata do të aplikojnë për secilën kategori minimale të bazës së taksës së parashikuar.

TABELA 3. Llogaritjet për detyrimin e taksave të biznesit të vogël

Nr.	Emërtimi i taksës/tarifës	Baza e taksës ⁶	Niveli i taksës ⁷	Niveli i taksës	Niveli i taksës
			Category I ⁸	Category II	Category III
	Tregti me pakicë	Xhiro deri në 2 milion Lek	45,000 Lek	25,000 Lek	23,000 Lek
2	Tregti me shumicë	Xhiro deri në 2 milion Lek	45,000 Lek	25,000 Lek	23,000 Lek
3	Prodhimi	Xhiro deri në 2 milion Lek	33,000 Lek	23,000 Lek	20,000 Lek
4	Shërbime	Xhiro deri në 2 milion Lek	25,000 Lek	20,000 Lek	20,000 Lek
5	Profesionistë të pavarur	Xhiro deri në 2 milion Lek	38,000 Lek	30,000 Lek	22,000 Lek
6	Tregtarë ambulantë	Xhiro deri në 2 milion Lek	8,000 Lek	5,000 Lek	5,000 Lek
7	Tregti me pakicë	Xhiro deri në 2-3 milion Lek	68,000 Lek	48,000 Lek	45,000 Lek
8	Tregti me shumicë	Xhiro deri në 2-3 milion Lek	68,000 Lek	48,000 Lek	45,000 Lek
9	Prodhimi	Xhiro deri në 2-3 milion Lek	55,000 Lek	45,000 Lek	43,000 Lek
10	Shërbime	Xhiro deri në 2-3 milion Lek	48,000 Lek	43,000 Lek	43,000 Lek
11	Profesionistë të pavarur	Xhiro deri në 2-3 milion Lek	60,000 Lek	53,000 Lek	45,000 Lek
12	Tregti me pakicë	Xhiro deri në 3-4 milion Lek	83,000 Lek	63,000 Lek	60,000 Lek
13	Tregti me shumicë	Xhiro deri në 3-4 milion Lek	83,000 Lek	63,000 Lek	60,000 Lek
14	Prodhimi	Xhiro deri në 3-4 milion Lek	70,000 Lek	60,000 Lek	48,000 Lek
15	Shërbime	Xhiro deri në 3-4 milion Lek	63,000 Lek	58,000 Lek	58,000 Lek
16	Profesionistë të pavarur	Xhiro deri në 3-4 milion Lek	75,000 Lek	68,000 Lek	60,000 Lek
17	Tregti me pakicë	Xhiro deri në 4-5 milion Lek	98,000 Lek	78,000 Lek	75,000 Lek
18	Tregti me shumicë	Xhiro deri në 4-5 milion Lek	98,000 Lek	78,000 Lek	75,000 Lek
19	Prodhimi	Xhiro deri në 4-5 milion Lek	85,000 Lek	75,000 Lek	73,000 Lek
20	Shërbime	Xhiro deri në 4-5 milion Lek	78,000 Lek	73,000 Lek	73,000 Lek
21	Profesionistë të pavarur	Xhiro deri në 4-5 milion Lek	90,000 Lek	83,000 Lek	75,000 Lek
22	Tregti me pakicë	Xhiro deri në 5-6 milion Lek	113,000 Lek	93,000 Lek	90,000 Lek
23	Tregti me shumicë	Xhiro deri në 5-6 milion Lek	113,000 Lek	93,000 Lek	90,000 Lek
24	Prodhimi	Xhiro deri në 5-6 milion Lek	100,000 Lek	90,000 Lek	88,000 Lek
25	Shërbime	Xhiro deri në 5-6 milion Lek	93,000 Lek	88,000 Lek	88,000 Lek
26	Profesionistë të pavarur	Xhiro deri në 5-6 milion Lek	105,000 Lek	98,000 Lek	90,000 Lek
27	Tregti me pakicë	Xhiro deri në 6-7 milion Lek	128,000 Lek	108,000 Lek	105,000 Lek
28	Tregti me shumicë	Xhiro deri në 6-7 milion Lek	128,000 Lek	108,000 Lek	105,000 Lek
29	Prodhimi	Xhiro deri në 6-7 milion Lek	115,000 Lek	105,000 Lek	103,000 Lek
30	Shërbime	Xhiro deri në 6-7 milion Lek	108,000 Lek	103,000 Lek	103,000 Lek
31	Profesionistë të pavarur	Xhiro deri në 6-7 milion Lek	120,000 Lek	110,000 Lek	105,000 Lek
32	Tregti me pakicë	Xhiro deri në 7-8 milion Lek	143,000 Lek	123,000 Lek	120,000 Lek
33	Tregti me shumicë	Xhiro deri në 7-8 milion Lek	143,000 Lek	123,000 Lek	120,000 Lek
34	Prodhimi	Xhiro deri në 7-8 milion Lek	130,000 Lek	120,000 Lek	118,000 Lek
35	Shërbime	Xhiro deri në 7-8 milion Lek	123,000 Lek	118,000 Lek	118,000 Lek

⁷ Niveli tregues i taksës për komunat është 50% e nivelit të saj tregues për secilën kategori. Këshilli bashkiak vendos nivelin e taksës bazë +/- 30% të nivelit tregues të secilës kategori të taksës.

⁸ Category classification of Municipalities are: (i) First Category: Tirana; Durrës; (ii) Second Category: Shkodra, Korça, Vlora, Saranda, Gjirokastra, Elbasani, Fieri, Lushnja, Pogradeci, Berati and Kavaja and (iii) Third Category: all the others

36	Profesionistë të pavarur	Xhiro deri në 7-8 milion Lek	135,000 Lek	128,000 Lek	120,000 Lek
	Transporti i pasagjerëve				
37	Automjete me deri në 5 vende	Numri i automjeteve	17,500 Lek		
38	Automjete me 6 - 9 vende	Numri i automjeteve	35,000 Lek		
39	Automjete me 10 - 25 vende	Numri i automjeteve	40,000 Lek		
40	Automjete me 26 - 42 vende	Numri i automjeteve	45,000 Lek		
41	Automjete me mbi 42 vende	Numri i automjeteve	48,000 Lek		
	Transporti i mallrave				
42	Automjete deri në 2 ton	Numri i automjeteve	28,000 Lek		
43	Automjete 2,1 - 5 ton	Numri i automjeteve	40,000 Lek		
44	Automjete 5,1 - 10 ton	Numri i automjeteve	48,000 Lek		
45	Automjete 10,1 - 16 ton	Numri i automjeteve	50,000 Lek		
46	Automjete mbi 16 ton	Numri i automjeteve	75,000 Lek		
	Transporti ujqor				
47	Transport ujqor brenda vendit	Numri i trageteve	55,000 Lek		
48	Transport ujqor liqenor	Numri i transportit liqenor	48,000 Lek		
49	Anije shplohëse biznesi	Numri i anijeve të biznesit	15,000 Lek		

TABELA 4. KATEGORIT MINIMALE DHE TREGUESE TE TAKSES MBI TOKEN BUJQESORE

Klasifikimi sipas rretheve			
1	2	3	4
Tiranë	Shkodër	Gjirokastër	Bulqizë
Durrës	Elbasan	Përmet	Has
Kavajë	Berat	Pogradec	Kukës
Krujë	Korçë	Librazhd	Tropojë
Lezhë	Delvinë	Dibër	Pukë
Lushnjë	Kurbin	Mat	Mirditë
Fier	Peqin	Skrapar	Malësi e Madhe
Vlorë	Kuçovë	Mallakastër	Gramsh
Sarandë		Devoll	Ersekë
		Tepelenë	

TABELA 5. VLERA E TAKSES NE LEK/HA

Klasifikimi sipas kategorisë së tokës	1	2	3	4
I	5 600	4 200	2 800	1 400
II	4 900	3 500	2 100	1 200
III	4 200	2 800	1 400	1 100

IV	3 600	2 300	1 350	1 000
V	3 000	1 900	1 250	900
VI	2 400	1 600	1 200	800
VII-X	1 800	1 400	1 100	700

Shënim: Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore bëhet nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

1.3.4 Taksat e përbashkëta

Praktika e ndarjes së vjeljes së taksave të përbashkëta nuk është aplikuar ende, por Ligjo për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore i përfshin ato si burime financiare. Pushteti qendror po diskuton me aktorë të ndryshëm se çfarë të përfshijë në taksat e përbashkëta. Dy taksa të mundshme të mira kombëtare për t'u bashkuar janë taksa për të ardhurat personale dhe korporate si dhe Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH).

TABELA 4. Buxheti i shtetit dhe të ardhurat e pushtetit vendor (në milionë lekë)

Nr.		2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
	Gjithsej të ardhura nga buxheti i shtetit	130,642	145,639	154,595	167,224	184,355	204,163	226,283	253,455
II	Të ardhura nga taksat	104,112	114,294	128,948	145,388	165,975	183,816	205,514	229,989
II1	Nga zyrat e tatimeve dhe doganave	81,103	87,776	98,088	108,777	123,101	135,605	155,097	173,975
II2	Të ardhurat nga pushteti vendor	2,957	4,012	5,224	7,923	9,613	12,019	11,112	13,214
1	Taksat dhe tarifave vendore	1,315	2,038	2,676	4,979	5,553	8,226	8,486	10,524
2	Taksa e biznesit të vogël	1,641	1,974	2,548	2,944	4,060	3,793	2,626	2,690
III	Të ardhura jo nga taksat	16,524	21,190	21,528	19,219	15,989	14,178	15,978	17,080

Në vitin 2007, të ardhurat e njërive të pushtetit vendor përfaqësonin vetëm 5.2% të të ardhurave totale të buxhetit të shtetit, ku taksa e biznesit të vogël kontribuon me 25.6% në të (e ardhura fiskale kjo më e rëndësishme për njësitë e pushtetit vendor). Rritja mesatare vjetore në të ardhurat e pushtetit vendor nga viti 2000 në vitin 2007 është 25%. Kjo rritje e rëndësishme është në sajë të përmirësimit të administrimit të taksave në njësitë e pushtetit vendor si dhe transferimi i taksave të reja nga niveli qendror në atë vendor.

Nga fundi i vitit 2005, bashkitë dhe komunat në Shqipëri ushtronin një sërë funksionesh të veta/ekskluzive, si infrastruktura lokale publike, krijimi i hapësirave të gjelbra, zhvillimi ekonomik vendor, veprimtaritë kulturore dhe sportive, etj. Decentralizimi funksional u ndërthur me një decentralizim të shëndoshë fiskal si nëpërmjet rritjes së shpejtë të transferimit nga qeveria qendrore, më së shumti me anë të rritjes së transfertave të pakushtëzuara duke përdorur shpërndarje të bazuar në formula, ashtu edhe nëpërmjet prezantimit të një pakete të taksave vendore duke i dhënë autoritetet të plotë në përcaktimin e tarifave për shërbimet vendore.

Transferimi i pronave të patundshme është duke vazhduar. Në vazhdim e sipër është edhe një propozim për t'i dhënë njërive të pushtetit vendor fondet për mirëmbajtjen e pronave të tilla, nëpërmjet transfertave të pakushtëzuara dhe/ose të kushtëzuara.

1.4 SHPENZIMET E PUSHTETIT VENDOR

Shpenzimet e përgjithshme të pushtetit vendor përfaqësojnë 21% të buxhetit total të shtetit ose vetëm rreth 6% të PKB (prodhimi kombëtar bruto). Shpenzimet vendore si përqindje e shpenzimeve totale

publike vazhdojnë të rriten, ndërkohë që koeficienti ndaj prodhimit kombëtar bruto është pothuajse në të njëjtin nivel siç ishte në fillim të këtij dhjetëvjeçari.

TABELA 3. Buxheti i shtetit dhe të ardhurat e pushtetit vendor (të dhënat makro—në milionë lekë)

	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Shpenzimet e buxhetit të shtetit	170,621	186,049	192,517	201,152	222,439	232,339	255,228	300,304
Buxheti i shtetit si % e PKB	32.0	31.5	30.6	29.0	29.6	28.3	28.4	30.6
Shpenzimet e pushtetit vendor	24,450	24,851	26,714	29,992	35,728	38,903	52,042	25,839
Transferta të kushtëzuara	18,437	17,465	14,426	15,748	19,824	18,904	22,994	NA
Transferta të pakushtëzuara	4,595	4,943	9,073	6,627	6,617	7,485	8,300	12,625
Të ardhurat e vetë njësisë vendore	1,418	2,443	3,216	7,617	9,287	12,514	20,748	13,214
Shpenzimet vendore si % buxhetit të shtetit	14.33	13.36	13.88	14.91	16.06	16.74	20.39	
Shpenzimet vendore si % e PKB	4.6	4.2	4.3	4.3	4.7	4.7	5.8	

2.0 HUAMARRJA E PUSHTETIT VENDOR

2.1 LIGJI PËR HUAMARRJEN E QEVERISJES VENDORE

Ligji Nr. 9869, datë 4 shkurt 2008, “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore” synon të zgjerojë autonominë financiare të njësive të pushtetit vendor. Ligji i lejon njësitet e pushtetit vendor të marrin hua:

- Për qarkullimin e parave dhe qëllime investimi
- Nga tregu i kapitalit – institucionet financiare dhe bankat, si dhe
- Në tregjet vendase dhe ndërkombëtare.

Maturimi i huasë mund të jetë afatshkurtër dhe afatgjatë.

Huatë afatshkurtër mund të merren për:

- Maturim jo më i madh se një vit buxhetor; dhe
- Për të financuar mungesën e përkohshme të likuiditeteve, kur shpenzimet operative janë më të mëdha se të ardhurat..

Kërkesa për hua afatshkurtër duhet t’i dërgohet së pari Ministrisë së Financave. Nëse Ministria e Financave e refuzon kërkesën e njësisë së pushtetit vendor, kryetari i bashkisë mund të marrë hua drejtpërdrejtë nga banka.

Shuma e përgjithshme e borxhit afatshkurtër, në asnjë rast, nuk mund të tejkalojë më shumë se dhjetë për qind (10%) të të ardhurave faktike, gjithsej, nga taksat dhe tarifat vendore dhe taksat e tatimet e ndara, të vitit fiskal, paraardhës.

Huatë afatgjate mund të merren për:

- Investime për qëllime publike; dhe
- Për të mbuluar funksionet vendore – të veta apo të përbashkëta (dhe të deleguara nëse është e nevojshme).

Huaja afatgjatë nuk mund të ketë maturim dhe nuk mund të bëhet e pagueshme përtej kohës së dobishme të investimit kapital, të financuar me të hyrat e kësaj huaje. Borxhi afatgjatë negociohet nga kryetari i bashkisë (personeli i tij), por vendimi përfundimtar merret nga këshilli bashkiak.

Shërbimi i borxhit, që duhet të paguhet, çdo vit, për borxhin afatgjatë, nuk mund të tejkalojë ***njëzet për qind (20%) të buxhetit total të të ardhurave nga transfertat e pakushtëzuar, taksat dhe tatimet e ndara dhe taksat e tarifat vendore, të tre viteve fiskale paraardhës të njësisë së qeverisjes vendore.***

2.1.1 Titujt e Pushtetit Vendor

Këtu përfshihen:

Garanci të ardhurash;

- Kolaterale të pronave fizike ky përfshihen:
 - Prona fizike në hapësira private, sipas ligjit për kthimin e pronave; dhe
 - Tokat e pazëna, ndërmarrjet, etj., por nuk mund të jenë shkollat, rrugët, etj.
- Huaja me detyrim të përgjithshëm:
 - Huaja, afatshkurtër dhe afatgjatë, e njësisë së qeverisjes vendore përbën detyrim të përgjithshëm të kësaj njësie, i pagueshëm si shpenzim parësor nga të gjitha fondet, ligjërisht të disponueshme, të njësisë së qeverisjes vendore, të cilat nuk janë vendosur si garanci për huadhënës të tjerë
- Hua me garanci specifike të ardhurash:
 - Veçanërisht për projekte specifike (d.m.th., huaja për investime në asete të furnizimit me ujë mund të garantohet nëpërmjet tarifës së furnizimit me ujë);
- Garancia dhe menaxhimi i llogarisë:
 - Detyrime të përgjithshme,
 - Garanci specifike të ardhurash, ose
 - Pronë fizike në hapësirë private;
- Të hyrat nga huaja dhe garancia e të ardhurave mund të mbahet në një llogari të llogari të veçantë financiare:
 - Për identifikim më të lehtë, ose
 - Garanci të tjera për huadhënësin.

2.1.2 Kufizimet e Borxhit

- Shërbimi i borxhit vjetor nuk duhet të tejkalojë:
 - njëzet për qind të buxhetit total të të ardhurave nga transfertat e pakushtëzuar, taksat dhe tatimet e ndara dhe taksat e tarifave vendore, të tre viteve fiskale paraardhës të njësisë së qeverisjes vendore,
 - shtatëdhjetë e një për qind e tepricës operative⁹ (teprica 1.4 herë më e madhe se shërbimi i borxhit).
- Stoku i borxhit jo më i madh se:
 - Njëqind e tridhjetë për qind e të ardhurave të pakushtëzuara.

2.2 KUFIRI PARAPRAK I HUAMARRJES PËR BASHKITË E SYNUARA

Sipas ligjit për huamarrjen e qeverisjes vendore, borxhi i bashkive i një viti për të gjitha huatë afatgjate nuk duhet të kalojë 20% të totalit të të ardhurave aktuale mesatare të qeverisë vendore nga transfertat e pakushtëzuara, taksat e përbashkëta dhe taksat dhe tarifave vendore të tre viteve të fundit fiskale.

TABELA 4. Kufizimi i huamarrjes për bashkitë e synuara të programit LGPA (në milionë lekë)

Bashkia e synuar	Limiti i huamarrjes/Maturimi i huasë (vite)					
	5	10	15	20	25	30
Fushë Kruje	147,473	361,913	662,676	1,084,511	1,676,158	2,505,972
Gramsh	109,503	266,932	487,734	797,420	1,231,772	1,840,972
Lezhë	107,683	263,848	482,876	790,074	1,220,936	1,825,243
Fier	580,809	1,410,464	2,574,097	4,206,153	6,495,195	9,705,696
Himarë	75,452	186,075	341,230	558,844	864,057	1,292,135
Librazhd	72,628	176,990	323,364	528,660	816,598	1,220,447
Shkodër	621,958	1,511,015	2,757,965	4,506,877	6,959,815	10,400,189
Kukës	145,829	350,915	638,559	1,041,995	1,607,834	2,401,453

⁹ Teprica operative llogaritet si diferenca e të ardhurave operative të njësive së qeverisjes vendore, nga burimet e veta, taksat e ndara dhe transfertat e pakushtëzuar me shpenzimet jo të kushtëzuara operative të njësisë së qeverisjes vendore.

Pogradec	249,213	610,227	1,116,567	1,826,736	2,822,785	4,219,795
Korçë	517,866	1,264,451	2,311,575	3,780,220	5,840,071	8,729,118

Këto të dhëna përfaqësojnë shumën totale të borxhit (principalin + interesin) dhe llogariten në bazë të të ardhurave mesatare të bashkive (totali i të ardhurave nga burimet e veta, taksat e përbashkëta¹⁰ si dhe transfertat e pakushtëzuara nga qeveria qendrore) për tre vitet e fundit (2005, 2006 dhe 2007) dhe ku presupozohet një rritje prej 7% në të ardhurat e pakushtëzuara të njërive të pushtetit vendor për vitet e ardhshme (deri në vitin 2036). Të njëjtat llogari në Euro jepen në Tabelën 5.

TABLE 5. Kufizimi i huamarrjes për bashkitë e synuara të programit LGPA (në milionë euro)

Bashkia e synuar	Limiti i huamarrjes/Maturimi i huasë (vite)					
	5	10	15	20	25	30
Fushë Kruje	1,180	2,895	5,301	8,676	13,409	20,048
Gramsh	876	2,135	3,902	6,379	9,854	14,728
Lezhë	861	2,111	3,863	6,321	9,767	14,602
Fier	4,646	11,284	20,593	33,649	51,962	77,646
Himarë	604	1,489	2,730	4,471	6,912	10,337
Librazhd	581	1,416	2,587	4,229	6,533	9,764
Shkodër	4,976	12,088	22,064	36,055	55,679	83,202
Kukës	1,167	2,807	5,108	8,336	12,863	19,212
Pogradec	1,994	4,882	8,933	14,614	22,582	33,758
Korçë	4,143	10,116	18,493	30,242	46,721	69,833

¹⁰ Të ardhura nga taksa të tilla që mblihen nga qeveria qendrore dhe transferohen tek njësitë e pushtetit vendor: (i) taksa për regjistrimin e automjeteve, dhe (ii) taksa për transferimin e pasurive të patundshme.

SHTOJCA A. TË DHËNA EKONOMIKE PËR BASHKITË E SYNUARA TË LGPA

Programi i Qeverisjes Vendore në Shqipëri punon me 10 bashki në të gjithë Shqipërinë. Të dhënat financiare të këtyre bashkive për vitin 2007 jepen në tabelën e mëposhtme.

TABELA 6. Të ardhurat e bashkive të synuara të programit LGPA (2007)

Lek (milione)	Gjithsej të ardhura të NJPV	Të ardhurat e vetë PV dhe të pakushtëzuara	Popullsia	Për frymë	Gjithsej të ardhura të PV	Të ardhurat e vetë PV dhe të pakushtëzuara
1 Shkodër	737,573	524,573	92,600	1 Librazhd	8.30	8.30
2 Fier	457,067	450,067	82,575	2 Gramsh	8.21	7.75
3 Korçë	425,544	399,044	64,388	3 Kukës	7.91	6.48
4 Pogradec	212,034	204,034	38,400	4 Himarë	6.26	6.26
5 Kukës	165,753	135,763	20,950	5 Korçë	6.61	6.20
6 Fushë Kruje	142,118	124,118	21,000	6 Fushë Kruje	6.77	5.91
7 Gramsh	89,134	84,134	10,862	7 Shkodër	7.97	5.66
8 Lezhë	82,815	82,815	23,150	8 Fier	5.54	5.45
9 Librazhd	60,085	60,085	7,238	9 Pogradec	5.53	5.31
10 Himarë	56,480	56,480	9,021	10 Lezhë	3.58	3.58

TABELA 7. Të dhëna buxhetore për 10 bashkitë e programit LGPA, 2003-2007 (faktik) dhe 2008 (plani)

Të Dhëna të Konsoliduara Financiare të Bashkisë Fushë Krujë

Lekë (milione)	2003	2004	2005	2006	2007	2008 (Plani)
Gjithsej të Ardhura	53,128	71,975	99,599	133,785	142,118	142,238
Transfertë e pakushtëzuar nga QQ	31,150	39,151	53,985	53,985	63,686	70,082
Transfertë e kushtëzuar nga QQ	4,572	12,970	18,000	22,000	18,000	
Të Ardhura nga Burimet e Veta	17,406	19,854	27,614	57,800	60,432	72,156
From Tax and Tariffs	14,404	16,598	23,777	54,620	57,192	68,956
Të Ardhura Jo-Takse	3,002	3,256	3,837	3,180	3,240	3,200
Gjithsej Shpenzime	53,128	71,975	99,599	133,785	142,118	142,238
Operative	31,877	43,185	59,759	80,271	85,271	85,343
Paga + kontributet shoqërore e	15,407	20,873	28,884	30,278	32,564	33,569
Mirëmbajtja	16,470	22,312	30,876	49,993	52,707	51,774
Investime	21,251	28,790	39,840	53,514	56,847	56,895

Të Dhëna të Konsoliduara Financiare të Bashkisë Gramsh

Lekë (milionë)	2003	2004	2005	2006	2007	2008 (Plani)
Gjithsej të Ardhura	55,584	57,593	82,434	95,079-	89,134	104,423
Transfertë e pakushtëzuar nga QQ	34,280	24,624	29,548	48,190	44,388	52,055
Transfertë e kushtëzuar nga QQ		9,969	10,000		5,000	
Të Ardhura nga Burimet e Veta	21,304	23000	42,886	46,889	39,746	52,368
Nga Taksat dhe Tarifat	12,378	13,144	22,394	26,620	20,375	31,882
Të Ardhura Jo-Takse	8,926	9,856	20,492	20,269	19,371	20,486
Gjithsej Shpenzime	55,584	57,593	82,434	95,079	89,134	104,423
Operative	39,465	40,891	58,528	67,506	63,285	74,140
Paga + kontributet shoqërore e shëndetësore	16,675	17,278	24,730	26,359	26,740	27,892
Mirëmbajtja	22,789	23,613	33,798	41,147	36,545	46,248
Investime	16,119	16,702	23,906	27,573	25,849	30,283

Të Dhëna të Konsoliduara Financiare të Bashkisë Lezhë

Lekë (milionë)	2003	2004	2005	2006	2007	2008 (Plani)
Gjithsej të Ardhura	87,225	58,673	78,355	84,359	82,815	103,584
Transfertë e pakushtëzuar nga QQ	25,469	25,469	25,469	37,470	43,069	54,002
Transfertë e kushtëzuar nga QQ	40,452	10,636	10,000	-		
Të Ardhura nga Burimet e Veta	21,304	22568	42,886	46,889	39,746	49,582
Nga Taksat dhe Tarifat	11,736	12,745	23,090	26,654	21,054	27,021
Të Ardhura Jo-Takse	9,568	9,823	19,796	20,235	18,692	22,561
Gjithsej Shpenzime	87,225	58,673	78,355	84,359	82,815	103,584
Operative	46,725	42,831	57,199	61,582	60,455	75,616
Paga + kontributet shoqërore e shëndetësore	26,168	26,259	27,893	28,000	29,367	31,075
Mirëmbajtja	20,558	16,572	29,306	33,582	31,088	44,541
Investime	40,500	15,842	21,156	22,777	22,360	27,968

Të Dhëna të Konsoliduara Financiare të Bashkisë Fier

Lekë (milionë)	2003	2004	2005	2006	2007	2008 (Plani)
Gjithsej të Ardhura	254,607	306,545	511,103	480,989	457,067	550,311
Transfertë e pakushtëzuar nga QQ	68,750	68,750	82,500	123,632	138,034	172,188
Transfertë e kushtëzuar nga QQ	60,564	105,137	40,073	20,000	7,000	
Të Ardhura nga Burimet e Veta	125,293	132,658	388,530	337,357	312,033	378,123
Nga Taksat dhe Tarifat	79,670	83,869	306,550	245,457	204,638	254,908
Të Ardhura Jo-Takse	45,623	48,789	81,980	91,900	107,395	123,215
Gjithsej Shpenzime	254,607	306,545	511,103	480,989	457,067	550,311
Operative	178,225	146,309	357,772	336,692	319,947	385,218
Paga + kontributet shoqërore e shëndetësore	66,198	79,702	112,639	125,057	126,932	135,896
Mirëmbajtja	112,027	66,607	245,133	211,635	193,015	249,322
Investime	76,382	160,236	153,331	144,297	137,120	165,093

Të Dhëna të Konsoliduara Financiare të Bashkisë Himarë

Lekë (milionë)	2003	2004	2005	2006	2007	2008 (Plani)
Gjithsej të Ardhura	11,749	20,796	57,387	66,542	56,480	73,377
Transfertë e pakushtëzuar nga QQ	7,046	7,906	7,906	19,895	25,523	35,143
Transfertë e kushtëzuar nga QQ		7,000	17,000	9,000		
Të Ardhura nga Burimet e Veta	4,703	5890	32,481	37,647	30,957	38,234
Nga Taksat dhe Tarifat	2,335	2,790	17,213	21,409	13,134	20,234
Të Ardhura Jo-Takse	2,368	3,100	15,268	16,238	17,823	18,000
Gjithsej Shpenzime	11,749	20,796	57,387	66,542	56,480	73,377
Operative	8,224	13,796	40,171	46,579	39,536	51,364
Paga + kontributet shoqërore e shëndetësore	6,235	8,953	14,392	15,639	16,944	17,000
Mirëmbajtja	1,989	4,843	25,779	30,940	22,592	34,364
Investime	3,525	7,000	17,216	19,963	16,944	22,013

Të Dhëna të Konsoliduara Financiare të Bashkisë Librazhd

Lekë (milionë)	2003	2004	2005	2006	2007	2008 (Plani)
Gjithsej të Ardhura	49,414	39,900	60,967	65,825	60,085	69,224
Transfertë e pakushtëzuar nga QQ	8,770	13,004	15,605	16,234	20,874	23,332
Transfertë e kushtëzuar nga QQ	15,202		7,000	12,500	-	
Të Ardhura nga Burimet e Veta	25,442	26,896	38,362	37,091	39,211	45,892
Nga Taksat dhe Tarifat	16,688	17,370	26,762	26,791	27,011	32,636
Të Ardhura Jo-Takse	8,754	9,526	11,600	10,300	12,200	13,256
Gjithsej Shpenzime	49,414	39,900	60,967	65,825	60,085	69,224
Operative	33,414	27,930	42,677	46,078	42,060	48,457
Paga + kontributet shoqërore e	14,824	15,200	16,800	17,589	18,026	19,263
Mirëmbajtja	18,590	12,730	25,877	28,489	24,034	29,194
Investime	16,000	11,970	18,290	19,748	18,026	20,767

Të Dhëna të Konsoliduara Financiare të Bashkisë Shkodër

Lekë (milionë)	2003	2004	2005	2006	2007	2008 (Plani)
Gjithsej të Ardhura	292,016	339,508	474,871	941,505	737,573	589,714
Transfertë e pakushtëzuar nga QQ	127,769	127,769	168,213	229,125	268,078	309,954
Transfertë e kushtëzuar nga QQ	22,644	52,503	41,473	425,000	213,000	
Të Ardhura nga Burimet e Veta	141,603	159,236	265,185	287,380	256,495	279,760
Nga Taksat dhe Tarifat	103,034	110,273	203,738	232,440	191,740	207,490
Të Ardhura Jo-Takse	38,569	48,963	61,447	54,940	64,755	72,270
Gjithsej Shpenzime	292,016	339,508	474,871	941,505	737,573	589,714
Operative	219,012	254,631	356,153	512,605	480,673	442,285
Paga + kontributet shoqërore e shëndetësore	84,685	98,457	137,712	159,236	169,236	171,017
Mirëmbajtja	134,327	156,174	218,441	353,369	311,437	271,268
Investime	73,004	84,877	118,718	428,900	256,900	147,428

Të Dhëna të Konsoliduara Financiare të Bashkisë Kukës

Lekë (milionë)	2003	2004	2005	2006	2007	2008 (Plani)
Gjithsej të Ardhura	68,674	93,140	95,936	143,781	165,763	136,034
Transfertë e pakushtëzuar nga QQ	37,106	45,888	55,066	97,408	93,962	91,908
Transfertë e kushtëzuar nga QQ	3,990	17,790			30,000	
Të Ardhura nga Burimet e Veta	27,578	29,462	40,870	46,373	41,801	44,126
Nga Taksat dhe Tarifat	23,252	24,259	18,749	28,347	20,262	21,800
Të Ardhura Jo-Takse	4,326	5,203	22,121	18,026	21,539	22,326
Gjithsej Shpenzime	68,674	93,140	95,936	143,781	165,763	136,034
Operative	50,132	67,992	70,033	104,960	121,007	99,305
Paga + kontributet shoqërore e shëndetësore	24,036	32,599	33,578	38,963	41,263	44,569
Mirëmbajtja	26,096	35,393	36,456	65,997	79,744	54,736
Investime	18,542	25,148	25,903	38,821	44,756	36,729

Të Dhëna të Konsoliduara Financiare të Bashkisë Pogradec

Lekë (milionë)	2003	2004	2005	2006	2007	2008 (Plani)
Gjithsej të Ardhura	94,702	126,652	178,618	208,143	212,034	428,025
Transfertë e pakushtëzuar nga QQ	24,623	24,623	29,548	65,811	92,220	93,109
Transfertë e kushtëzuar nga QQ	4,990	23,493	21,184	21,000	8,000	188,564
Të Ardhura nga Burimet e Veta	65,089	78,536	127,886	121,332	111,814	146,352
Nga Taksat dhe Tarifat	18,963	21,256	32,229	51,412	42,562	42,212
Të Ardhura Jo-Takse	46,126	57,280	95,657	69,920	69,252	104,140
Gjithsej Shpenzime	94,702	126,652	178,618	208,143	212,034	428,025
Operative	66,291	88,656	125,033	145,700	148,424	239,461
Paga + kontributet shoqërore e shëndetësore	37,881	50,661	71,447	78,963	81,263	89,639
Mirëmbajtja	31,230	40,090	55,766	66,737	67,161	149,822
Investime	25,592	35,902	51,766	62,443	63,610	188,564

Të Dhëna të Konsoliduara Financiare të Bashkisë Korçë

Lekë (milionë)	2003	2004	2005	2006	2007	2008 (Plani)
Gjithsej të Ardhura	251,561	291,454	440,740	446,511	425,544	495,211
Transfertë e pakushtëzuar nga QQ	76,565	76,565	84,189	111,490	120,772	166,785
Transfertë e kushtëzuar nga QQ	61,126	62,257	64,928	49,500	26,500	
Të Ardhura nga Burimet e Veta	113,870	152,632	291,623	285,521	278,272	328,426
Nga Taksat dhe Tarifat	85,623	93,625	240,358	233,140	267,784	278,148
Të Ardhura Jo-Takse	28,247	59,007	51,265	52,381	10,488	50,278
Gjithsej Shpenzime	251,561	291,454	440,740	446,511	425,544	495,211
Operative	183,640	212,761	321,740	325,953	310,647	361,504
Paga + kontributet shoqërore e shëndetësore	75,468	87,436	113,963	123,965	127,663	138,967
Mirëmbajtja	108,171	125,325	207,777	201,988	182,984	222,537
Investime	67,921	78,693	119,000	120,558	114,897	133,707

Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar
Programi i Qeverisjes Vendore në Shqipëri
Rr. Dervish Hima
3 Kullat prapa Stadiumit “Qemal Stafa”
Kulla Nr. 1, Apt. 91, kati 10
Tiranë, Shqipëri
Tel: 355-04-271-355
www.usaid.gov